



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, Datë 05.05.2015

PËR

RISHIKIMIN E “STUDIMIT URBANISTIK PËR ZGJERIMIN E  
MASTERPLANIT TË VELIPOJËS, PËR ZHVILLIMIN TURISTIK TË ZONËS  
BREGDETARE PULAJ”, MIRATUAR ME VENDIM TË KKT-SË NR. 12 DATË  
01.06.2012, DHE MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR 6 REZIDENCAT  
DHE OBJEKTET E SHËRBIMIT, NË ZONËN BREGDETARE PULAJ, ISH-  
KOMUNA VELIPOJË, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit” dhe Vendimit nr. 12 datë 01.06.2012 “Për miratimin e detyrës së projektimit dhe studimit urbanistik për zgjerimin e masterplanit të Velipojës, për zhvillimin turistik të zonës bregdetare Pulaj dhe studim urbanistik pjesor me sipërfaqe 4.4 ha, në zonën bregdetare Pulaj, pjesë e shtesës së ristudimit urbanistik dhe i mbrojtjes së bregut të detit në Velipojë, Ish-Komuna Velipojë, Qarku Shkodër”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rishikimit të “Studimit urbanistik për zgjerimin e masterplanit të Velipojës, për zhvillimin turistik të zonës bregdetare Pulaj”, miratuar me vendim të KKT-së nr. 12 datë 01.06.2012 dhe miratimin e lejes së ndërtimit për 6 rezidencat dhe objektet e shërbimit, në zonën bregdetare Pulaj, ish-Komuna Velipojë, Qarku Shkodër”, me subjekt kërkues “Xhenis” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Studimi urbanistik i rishikuar dhe plani i vendosjes së 6 rezidencave dhe objekteve të shërbimit;
  - b. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.



4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.

5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Komuna Velipojë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYETARI**

**EDI RAMA**

**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**ARBEN AHMETAJ**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT E TERRITORIT**

